

VENDIM
Nr.13, datë 4.5.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:			
Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Kujtim Puto	Anëtar	i	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	Anëtar	i	“ “
Sokol Berberi	Anëtar	i	“ “
Admir Thanza	Anëtar	i	“ “
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 3.3.2009, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentash çështjen nr.4 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

SUBJEKTI I INTERESUAR: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i nenit 36/1 të ligjit nr.9487, datë 06.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, germa “d”, dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, pasi shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe e bisedoi atë në tërësi,

VËREN:

I

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka nisur procedimin penal ndaj të pandehurit K.P., duke e akuzuar për veprën penale “kundërshtim të punonjësve të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal. I pandehuri është babai i dy djemve, të cilët kanë refuzuar kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Për këtë arsye, punonjësit e policisë kanë kryer shoqërimin me forcë të dy djemve, që i kanë gjetur në banesën e tyre, për te qendra e rekrutim-mobilizimit. Po kështu, ata kanë shoqëruar dhe të pandehurin me pretendimin se ai i kishte kundërshtuar me forcë.

Me vendimin datë 21.04.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e akteve Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur për kushtetutshmërinë e nenit 36/1 të ligjit nr.9487, datë 06.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë nen parashikohet se: *“Organet e Policisë së Shtetit në qarqe detyrohen të shoqërojnë nëpër qendrat e rekrutim-mobilizimit të qarkut shtetasit të cilët janë thirrur për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, sipas listëthirrjeve të dërguara nga QRM dhe që nuk janë paraqitur në qendrën e rekrutim-mobilizimit. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Brendshëm nxjerrin udhëzim të përbashkët për zbatimin e këtij neni”.*

Kërkuesi, për shfuqizimin e nenit 36/1 të ligjit nr.9487, datë 6.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e

Shqipërisë”, ka parashtruar këto shkaqe:

- ky nen bie ndesh me frymën dhe parimet e përgjithshme të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe me nenet 17/2, 27/2, 37 të Kushtetutës;

- sipas paragrafit 2 të nenit 17/2 të Kushtetutës, kufizimi i lirisë dhe i të drejtave për interes publik nuk mund të cenohet thelbin e tyre dhe, në asnjë rast, nuk mund të tejkalohet kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Mënyra se si është formuluar neni 36/1 i ligjit për shërbimin ushtarak u lë dorë të lirë organeve të policisë të ushtrojnë kontrolle banese në çdo kohë dhe të shoqërojnë rekrutët dhe familjarët e tyre, duke i mbajtur në komisariate pa kufizim. Kjo dispozitë është një tejkalim i kufizimeve të parashikuara në Kushtetutë dhe në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, pasi i hap rrugë arbitraritetit të organeve policore.

Kuvendi i Shqipërisë, si palë e interesuar, ka pretenduar se sipas nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, duhet të ekzistojë lidhje e drejpërdrejtë mes ligjit, objekt kërkesë, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

Në rastin konkret, Gjykata nuk pengohet nga verifikimi i kushtetutshmërisë së nenit në fjalë për të zgjidhur me themel çështjen, pasi kontrolli kushtetues i dispozitës së ligjit, objekt i kërkesës, nuk do të ndikonte në “fatin” e procedimit penal, sepse kundërshtimi i punonjësit të policisë gjatë përmbushjes së detyrës së tij në bazë të një ligji, nuk mund të legjitimohet si veprim i justifikueshëm nga pikëpamja ligjore. Kundërshtimi që i ka bërë i pandehuri policisë, do të kishte justifikim vetëm në raste kur policia vepron në kundërshtim me ligjin në fuqi.

II

Kërkuesi ka parashtruar se paragrafi i parë i nenit 36/1 i ligjit nr.9487, datë 6.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë” është antikushtetues.

Neni 145, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë u njeh të drejtën gjyqtarëve, që në çdo fazë të gjykimit, kur ato çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve, që për inicues ka gjykatat e sistemit të zakonshëm.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka pranuar se ky lloj gjykimi kushtetues kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis ligjit, antikushtetutshmëria e të cilit çmohet si e tillë nga gjykata dhe zgjidhjes së çështjes konkrete (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.15, datë 7.04.2000*).

Para marrjes së vendimit të pezullimit, gjyqtari apo gjykata duhet të konkludojnë se gjykimi që ata kanë nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Pra, gjyqtari apo gjykata duhet të çmojnë se ligji që vlerësojnë si antikushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes. Në të kundërt, nëse gjyqtari çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e tij për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas tij vlerësohet si antikushtetues, ai duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes. Në mënyrë që të ekzistojë lidhje e drejpërdrejtë duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga kjo gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata kërkuese, në kuptimin që gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se ekziston lidhja e drejpërdrejtë, kur mënyra e zgjidhjes së çështjes konkrete, që është në shqyrtim nga gjykata, do të varet nga vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjit. Nuk do të ekzistonte lidhja e drejpërdrejtë nëse kushtetutshmëria apo jo e çështjes nuk do të sillte dhe ndryshime për pasojat e mundshme të çështjes. Parë në këtë aspekt, gjykata apo gjyqtari është i kushtëzuar në dërgimin e çështjes në Gjykatë Kushtetuese nga kriteri procedural “lidhje e drejpërdrejtë”, përcaktuar nga neni 68 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin

dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

Në çështjen e paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, kërkuesi nuk e ka vlerësuar siç duhet këtë kriter të rëndësishëm, pasi për rastin në shqyrtim, kjo lidhje nuk është evidente, sepse i pandehuri është akuzuar për veprën penale “kundërshtim i punonjësve të policisë së rendit”, akuzë që kërkuesi duhet ta shqyrtojë mbi bazën e verifikimit të elementeve të kësaj figure të veprës penale, sanksionuar nga neni 236 i Kodit Penal. Nëse do të kërkohej antikushtetutshmëria e kësaj dispozite, atëherë mund të thuhej se mund të ekzistonte lidhje e drejtpërdrejtë mes ligjit, për të cilin kërkohet antikushtetutshmëria, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.3, datë 6.02.2008*). Gjykata Kushtetuese vlerëson se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë edhe për arsyen se në cilësinë e të pandehurit ka qenë babai i dy djemve, të cilët ishin subjekte të ligjit nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”.

Pra, në rastin konkret, kërkuesi nuk pengohet nga verifikimi i kushtetutshmërisë së nenit në fjalë, për të zgjidhur me themel çështjen, pasi edhe nëse hipotetikisht do të shpallej antikushtetuese dispozita e ligjit, objekt i kërkesës, kjo nuk do të pengonte për një vendim lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit. Në asnjë rast kundërshtimi i punonjësit të policisë, gjatë përmbushjes së detyrës së tij në bazë të një ligji, nuk mund të konsiderohet si veprim i justifikueshëm nga pikëpamja ligjore.

Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese e konsideron si të padrejtë pretendimin e kërkuesit, sepse nuk ekziston lidhja e drejtpërdrejtë mes nenit 36/1 të ligjit nr.9487, datë 06.03.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë” dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

Sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (Kryetar) Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Fehmi Abdiu, Admir Thanza